



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.842/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Besim Rexhepi, kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Viti, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Besim Rexhepi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik PDK me seli në Prishtinë, dega në Viti, me shenjën ZL.Anr.842/2017, i datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 09:55, ka pranuar një apel nga Besim Rexhepi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik PDK, i cili në apelin e paraqitur ka theksuar se në vendvotimet: 2609d/03d, 2609d/02r, 2609d, 2601x/05d, 2601x/04r, 2601x/03r, 2601x/02r, 2601x/01r, 2601d/05d, 2601d/04dr, 2601d/02r, 2601d/01r, 26010/03r, 2627d/01r, 2627d/02r, janë bartur votat e kandidatëve brenda subjektit politik PDK.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se, apeluesi nuk e ka bere asnjë kërkesë ndaj PZAP-it por vetëm ka përshkruar QV-të dhe VV-të, duke mos e theksuar për secilin VV sa vota i mungojnë. Prandaj Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte bindëse dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të specifikimit të nr. të votave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara mirë dhe si i tillë apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.842/2017 me datën 12.11.2017.

Kryesues i Panelit
Zyhdi Haxhiu



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.